

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 1


Kjo rregullore përcakton kompetencat dhe rregullat e funksionimit administrativ të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT).

Neni 2

ERT është person juridik publik, jobuxhetor që funksionon në përputhje me ligjin nr.8288, datë 18.2.1998 "Për Entin Rregullator të telekomunikacioneve", si dhe me këtë rregullore.

Neni 3

Për realizimin e funksioneve të tij ERT-ja e organizon veprimtarinë sipas strukturës që është miratuar nga Këshilli Drejtues dhe që paraqitet më poshtë:



Neni 4

Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimor i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve. Ai e zhvillon veprimtarinë nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë të Këshillit Drejtues.

Neni 5

ERT-ja është i detyruar të zbatojë të gjitha vendimet e Këshillit Drejtues, që synojnë realizimin e funksioneve të Entit.

Neni 6

Këshilli Drejtues mbledhet sa herë është e nevojshme. Mbledhjet thirren me kërkesë të kryetarit ose të secilit anëtar. Këshkesa shoqërohet me materialet që do të shqyrtohen në mbledhje, të cilat iu shpërndahen anëtarëve të Këshillit Drejtues jo më pak se dy ditët përpara mbledhjes.

Neni 7

Mbledhja e Këshillit Drejtues drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga njëri preej anëtarëve, i cili është autorizuar nga kryetari.

Neni 8

Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahet procesverbal. Procesverballi nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje. vendimet e mbledhjeve nënshkruhen nga kryetari ose nga drejtuesi i autorizuar i mbledhjes dhe ruhen të protokolluar.

Neni 9

Veprimtaria epunonjësve të ERT-së udhëhiqet nga transparenca dhe kolegialiteti.

Neni 10

Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe punonjësit administrativë të ERT-së detyrohen të ruajnë sekretin profesional për faktet, informacionet dhe aktet për të cilat janë vënë në dijeni për shkak të detyrës që ata kryejnë. Për shkeljet në këtë drejtim mbahet përgjegjësi sipas dispozitave ligjore.

Neni 11

Këshilli Drejtues ka këto detyrua kryesore:

1. Miraton të gjitha aktet që nxjerr ERT-ja në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8288, datë 18.2.1998 "Për Entin Rregullator të telekomunikacioneve".
2. Miraton strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe pagat e tyre.
3. Miraton rregullat dhe kriteret e punësimit të punonjësve të ERT-së.
4. Miraton Jdo vit fondin e shpenzimeve operative dhe të investimeve, që i paraqitet Këshillit të Ministrave.
5. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë rregullatore, gjendjes ekonomike, si dhe parashikimet për vitin pasardhës, i cili dërgohet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Kryetari i Këshillit drejtues është drejtor ekzekutiv i ERT-së. Ai ka për detyrë:

1. Të marrë të gjitha masat për realizimin e detyrave që i ngarkon ligji i ERT-së.
2. Të krijojë marërdhënie me të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilëve lidhet me realizimin e funksioneve të ERT-së.
3. Të paraqesë në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend raportin e veprimtarisë vjetore të ERT-së.
4. Të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave fondin e shpenzimeve operative dhe të investimeve të planifikuara për vitin e ardhshëm.
5. Të vendosë për marrjen në punë, ngritjen e uljen në detyrrë të punës të Entit, mbi bazën e propozimeve të drejtorëve përkatës.
6. Të organizojë dhe të drejtojë mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të kujdeset për zbardhjen e vendimeve të marra në këto mbledhje.
7. Të mbikëqyrë në vazhdimësi veprimtarinë rregullatore dhe ekonomiko-financiare të Entit.

Neni 13

12. Drejtori ekzekutiv mban përgjegjësi para Këshillit Drejtues për detyrat që i ngarkon neni

Neni 14

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë drejtorë të drejtorive të ERT-së.

Neni 15

Drejtorët e drejtorive organizojnë dhe majnë përgjegjësi për drjetimin dhe kryerjen e detyrave të sektorëve që mbulojnë. Ata kanë të drejtë të propozojnë të gjitha ndryshimet e nevojshme në organizimin e punës në ERT për realizimin sa më mirë të objektivave që u janë ngarkuar, të propozojnë marrjen në punë të punonjësve të drejtorive që drejtojnë, të caktojnë specialistët që do të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme, si dhe të bashkërendojnë punën me drejtoritë e tjera.

Neni 16

Drejtoria e licencimeve ka këto detyra kryesore:

1. Përpunon politikën e licencimit si dhe modelet përkatëse të licencave;
2. Përgatit licencat për të gjitha shërbimet;
3. Kontrollon zbatimin e kushteve të licencave të dhëna;
4. Verifikon ankesat lidhur me praktika antikonkurrencë dhe/ose abuzim me statusin e të qenit monopol dhe propozon masat përkatëse;
5. Llogarit detyrimet financiare të subjekteve që licencohen;
6. Ndjek zbatimin e urdhërave të nxjera nga ERT-ja për shkeljet e ndryshme të legjislacionit ose kushteve të licencave;
7. Ndjek detyrimet ligjore të ERT-së për licencimin e radioamatorëve.

Neni 17

Drejtoria e radiokomunikacioneve ka këto detyra kryesore:

1. Merr pjesë në hartimin e planit kombëtar të ndarjes së brezave të frekuencave;
2. Administron brezat e frekuencave për gjithë përdoruesit civilë;
3. Harton rregulloren kombëtare të radiokomunikacioneve;
4. mban dhe azhuron regjistrat, i përmirëson ato nëpërmjet përdorimit të metodave bashkëkohore;
5. Inspekton instalimet radio, për kontrollin e pajtueshmërisë së tyre me kushtet e licencës;
6. Mban marrëdhëniet me administratat e huaja dhe organizatat ndërkombëtare për shërbimet e radiokomunikacionit dhe administrimin e spektirt;
7. Monitoron spektrin e frekuencave;
8. Mbikëqyr administrimin e rrjetit internet lidhur me detyrimet që ka ERT-ja.

Neni 18

Drejtoria Teknike dhe e Konkurrencës së Rrjeteve që ka këto detyra kryesore:

1. Shqyrton në aspektin tekniko-ekonomik kërkesat për licencim të subjekteve, lidhur me zbatimin e rregullave për një konkurrencë të ndershme dhe mbrojtjen e interesave të

konsumatorit;

2. Përshtat standardet ndërkombëtare në kërkesa teknike për t'u zbatuar në vendin tonë;
3. Verifikon konformitetin me kërkesat teknike të miratuara, për pajisjet e telekomunikacioneve që lidhen me rrjetet publike;
4. Harton dhe administron planin kombëtar të numeracionit;
5. Ndihmon në arritjen e marrëveshjeve dhe arbitron në zgjidhjen e konflikteve në fushën e interkoneksionit;
6. Kontrollon operatorët, ofuesit e shërbimit dhe tregtarët e pajisjeve në aspektet e cilësisë së shërbimit dhe konformitetin me kërkesat teknike;
7. Harton metodologjinë e caktimit të tarifave të shërbimeve mbi bazën e një politike për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Neni 19

Drejtoria Ekonomike dhe e Administrimit ka këto detyra kryesore:

1. Planifikon, zbaton dhe kontrollon veprimtarinë financiare të ERT-së;
2. Krijon dhe mban evidencat ekonomike dhe financiare, në përputhje me legjislacionin shqiptar;
3. Menaxhon problemet e personelit, motivimin dhe pagon sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të ERT-së dhe ligjeve e vendimeve përkatëse nëfuqi;
4. Konsulton nga ana juridike aktet që nxjerr ERT-ja;
5. Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përfaqëson ERT-në në konfliktet juridike me ose ndërmjet operatorëve dhe konsumatorit;
6. Rakordon me zyrën e tatim taksave vjeljen e taksës nacionale për radiokomunikacionin;
7. Publikon aktet e nxjerra nga ERT-ja.

Neni 20

Të gjitha shtesat dhe ndryshimet e kësaj rregulloreje bëhen me miratim e jo më pak se katër anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Tiranë, më 23.10.1998